



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3742/Prot.
2

Rrëshen më, 06 .10 . 2025

V E N D I M

Nr. 81 datë 30. 09. 2025

P Ë R

**“MIRATIMI E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË
(PVVEE) 2025-2028, SIPAS KONTRATËS SË GRANTIT IPA/2023/450-172 NË KUADËR
TË PROJEKTIT “EFFORT” FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 124/2015 “Për eficiency e energjisë”, i ndryshuar, Urdhëri nr. 206, datë 25.10.2022, “Për miratimin e formatit të planeve vendore të veprimit për eficiency e energjisë dhe raporti i progresit për zbatimin e planeve”, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Mirditë, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKTRSH) Nr. 2, datë 20.06.2018, ligji nr. 37/2015, “Për Ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër Ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për Rregullat e Zbatimit të Mbështetjes Financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), ligji nr. 61/2019, “Për Ratifikimin e marrëveshjes së Financimit Ndërmjet Republikës së Shqipërisë , Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për Programimin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, kontratës së Grantit IPA/2023/450-172 për projektin “EFFORT” financiar nga Bashkimi Evropian, Marrëveshjes së Partneritetit për zbatimin e projektit “EFFORT” nr. 389 Prot. datë 26/ 01/ 2024, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 101 datë 03.04.2025 dhe shkresës me nr. 359/1 Prot. datë 12.08.2025 të Agjencisë për Eficiency e Energjisë me lëndë: Komentë dhe miratim për Planin Lokal të Veprimit për Eficiency e Energjisë, realcionin nr. 3742 prot, datë 17.09.2025 e PVVEE, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, pas shqyrtimit e diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Të miratojë Planin Vendor të Veprimit për Eficiency e Energjisë (PVVEE) 2025-2028 hartuar në kuadër të projektit “EFFORT” të financiar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit IPA-CBC Shqipëri-Kosovë i hartuar në bashkëpunim me partnerin në Projekt Co-Plan Institut i Zhvillimit të Habitatit
2. Relacioni nr. 3742 prot, datë 17.09.2025, së bashku me PVVEE 2025-2028, *bashkëlidhur pjesë përbërse e këtij vendimi*

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, (sektori për integrimin Evropian dhe projektet)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAËU





GTopollog

BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3792/Prot
1

Rrëshen 17.09. 2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 80 datë 17.09. 2025

PËR

**“MIRATIMI E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË 2025-2028
SIPAS KONTRATËS SË GRANTIT IPA/2023/450-172 NË KUADËR TË PROJEKTIT
“EFFORT” FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 124/2015 “Për eficiency e enërgjisë, i ndryshuar, urdhërit nr. 206 datë 25/ 10/ 2022 “Për miratimin e formatit të planeve vendore të veprimit për eficiency e enërgjisë dhe raporti i progresit për zbatimin e planeve”, Planit të Përgjithshëm Vendorë të Bashkisë Mirditë i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, datë 20.06.2018, ligjit nr. 37/2015 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër Ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për Rregullat e Zbatimit të Mbështetjes Financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), ligjin nr.61/2019 “Për Ratifikimin e marrëveshjes së Financimit Ndërmjet Republikës së Shqipërisë , Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për Programimin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, kontratës së Grantit IPA/2023/450-172 për projektin “EFFORT” financiar nga Bashkimi Evropian, Marrëveshjes së Partneritetit për zbatimin e projektit “EFFORT” nr. 389 Prot. datë 26/ 01/ 2024, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 101 datë 03.04.2025 dhe shkresës me nr. 359/1 Prot. datë 12.08.2025 të Agjencisë për Eficiency së Energjisë me Lëndë: Komete dhe miratim për Planin Lokal Të Veprimit për Eficiency e Energjisë.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Vendor të Veprimit për Eficiency e Enërgjisë (PVVEE) 2025-2028 hartuar në kuadër të projektit “EFFORT” të financiar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit IPA-CBC Shqipëri-Kosovë i hartuar në bashkëpunim me partnerin në Projekt Co-Plan Institut i Zhvillimit të Habitatit

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Mirditë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

SEKRETAR
Gasper TOPOLLAJ

KRYETAR
Aleksandë PICA KU

Paraqiti Projektin:

Sektori për Integrimin Evropian dhe Projektet: P/Sek, Gjovalin Marfana

Drejtoria Juridike,: Dr, Manjola Doda



KRYETARI
Albert MELYSHI





BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3742. Prot

Rrëshen 17.09. 2025

RELACION

PËR

**“MIRATIMI E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË
2025-2028 SIPAS KONTRATËS SË GRANTIT IPA/2023/450-172 NË KUADËR TË
PROJEKTIT “EFFORT” FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN**

Të nderuar Këshilltarë!

1. HYRJE DHE OBJEKTIVA

Bashkia Mirditë ka ndërmarrë një qasje sistematike për rritjen e efijencës së energjisë në nivel lokal, duke hartuar Planin Vendor të Veprimit për Efijencën e Energjisë (PVVEE) në bashkëpunim me projektin EFFORT. Plani bazohet në Ligjin nr. 124/2015 "Për efijencën e energjisë".

Objektiva kryesore:

Qëllimi kryesor i këtij plani është përafrimi i objektivave të tij me objektivat e Planit Kombëtar për Efijencën së Energjisë (PKEE), duke parashikuar veprime konkrete dhe të matshme në nivel lokal. Objektivat kryesore të Planit Vendor të Veprimit për Efijencën e Energjisë janë:

- **Përmirësimi i Efijencës së energjisë në infrastrukturën publike dhe private** - prioritet kryesor me synimin për të arritur kursim energjie me 15% deri në vitin 2030. Ky objektiv do të realizohet përmes rinovimit të ndërtesave dhe zbatimit të teknologjive të reja që ndihmojnë në reduktimin e koston e energjisë.
- **Promovimi i teknologjive të reja dhe reduktimi i emetimeve të CO2** - përfshirje e rëndësishme së përdorimit efikas dhe ekonomik të burimeve të energjisë, si dhe nxitjen e përdorimit të energjive të rinovueshme nga qytetarët dhe kompanitë.
- **Rritja e sigurtisë së furnizimit me energji dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme** - një aspekt i rëndësishëm i politikave energjetike të bashkisë për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm energjetik.
- **Kontributi në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit** - përmes përmirësimit të cilësisë së jetesës për të gjithë komunitetin dhe mbrojtjes së mjedisit.

Këto objektiva me karakter të qartë dhe të matshëm synojnë të reduktojnë emetimet e CO2, të rrisin efijencën e energjisë dhe të promovojnë përdorimin e teknologjive të reja. Realizimi i tyre do të arrihet përmes rinovimit të infrastrukturës publike dhe mbështetjes së përdorimit të burimeve të rinovueshme nga qytetarët dhe bizneset. Ky plan do të shërbejë si një udhërrëfyes për të realizuar këto qëllime në afatin e parashikuar dhe do të monitorohet vazhdimisht për të siguruar që objektivat e tij të arrihen në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme.

Grupi i punës i përbërë nga ekspertë të Co-PLAN dhe drejtoritë e Bashkisë ka mbledhur të dhënat bazë për ndërtimin e planit, duke siguruar që masat e propozuara të jenë sa më të përshtatshme për realizim.

2. SITUATA AKTUALE E KONSUMIT TË ENERGJISË

Bashkia Mirditë ka një konsum total prej **17.8 GWh** në vit, që përfaqëson vetëm 0.22% të konsumit total kombëtar. Analiza e konsumit tregon:

Shpërndarja e konsumit:

- **61%** nga sektori rezidencial (10,800 MWh)
- **19%** nga bizneset
- **3.7%** nga ndërtesat publike të Bashkisë (652 MWh me kosto 12 milionë lekë)

Burime të tjera energjie:

- **Nafta:** 48,767 litra për transport dhe 34,960 litra për ngrohje (kosto: 17 milionë lekë)
- **Druri:** 314 m³ për ngrohje (kosto: 1,432,000 lekë)

Performanca e ndërtesave publike: Analiza e 105 kontratave tregon se 35% e kontratave kanë konsum zero, kryesisht shkolla të mbyllura për mungesë nxënësish. Ndërtesat me konsumin më të lartë janë:

- Bashkia Mirditë Rreshen: 147,920 kWh
- Ujësjiellësi Bukimirë: 48,960 kWh
- Shkolla 9-vjeçare nr.3: 25,443 kWh

3. MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇENCËS

Strategjia e masave është e strukturuar në katër kategori kryesore:

3.1 Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Energjisë

- Krijimi i strukturave vendore për menaxhimin e energjisë
- Përmirësimi i kapaciteteve menaxheriale
- Implementimi i sistemeve për monitorim dhe vlerësim

3.2 Përmirësimi i Efikasitetit në Ndërtesa Publike

- Instalimi i paneleve fotovoltaike në 10 ndërtesa publike prioritare
- Izolimi termik i ndërtesave
- Zëvendësimi i dritareve dhe sistemeve të ngrohjes
- Përdorimi i pajisjeve efçente

3.3 Përmirësimi i Shërbimeve Bashkiake

- Modernizimi i sistemit të ndriçimit publik me LED
- Optimizimi i sistemeve të vaditjes dhe furnizimit me ujë
- Përmirësimi i flotës së automjeteve

3.4 Përfshirja e Komunitetit dhe Bizneseve

- Organizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere
- Promovimi i efçencës së energjisë për komunitetin
- Mbështetje për bizneset në adoptimin e teknologjive të gjelbra

4. ANALIZA E EMETIMEVE DHE PËRFITIMEVE MJEDISORE

Implementimi i masave do të sjellë:

Reduktimi i emetimeve të CO₂: Për çdo 1 kWh energji të prodhuar nga panelet fotovoltaike, kursehet 1 kWh energji nga rrjeti, duke reduktuar emetimet përkatëse të gazeve serrë.

Përfitime ekonomike:

- Ulje e kostove operacionale për institucionet publike
- Kursime afatgjata për qytetarët dhe bizneset
- Rritje e vlerës së pasurive përmes përmirësimeve energjetike

Përfitime sociale dhe mjedisore:

- Përmirësimi i cilësisë së ajrit
- Rritja e ndërgjegjësimit mjedisor
- Kontributi në zhvillimin e qëndrueshëm lokal

5. FINANCIMI DHE ZBATIMI

Buxheti total i vlerësuar: 94,325,000 lekë për periudhën 2025-2028

Burimet e financimit:

Burimi	Viti I	Viti II	Viti III	Totali
Buxheti i shtetit	7,600,000	9,800,000	9,800,000	27,200,000
Buxheti vendor	5,030,000	5,890,000	5,890,000	16,800,000
Grante ndërkombëtare	19,425,000	20,425,000	10,425,000	50,325,000

Zbatimi dhe Monitorimi:

- Krijimi i grupit të punës të dedikuar
- Koordinimi me njësitë e qeverisjes vendore
- Raportimi i rregullt sipas Urdhërit Nr. 206/2022
- Monitorimi i progresit dhe përshtatja e masave

Sfidat dhe mundësitë:

- Nevoja për koordinim midis aktorëve
- Rreziku i vonësve në alokimin e fondeve
- Mundësi për partneritete publike-private
- Potenciali për zgjerime të mëtejshme të projektit

5. PËRFUNDIM

PVVEE për Bashkinë Mirditë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një të ardhme më të qëndrueshme energjetike. Me një financim prej mbi 94 milionë lekësh dhe masa konkrete që synojnë një efikasitet 15% deri në 2030, plani do të kontribuojë në uljen e kostove, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mbrojtjen e mjedisit. Suksesi i planit varet nga koordinimi efikas i aktorëve, menaxhimi i mirë i burimeve financiare dhe angazhimi i komunitetit për të mbështetur masat e propozuara.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Menaxher i Projektit EFFORT nga Co-Plan: Ing. Elvis Ndreka

Spektori për Integrimin Evropian dhe Projektet: P/Sek, Gjovalin Marfana

Drejtoria Juridike,: Dr. Manjola Doda

KRYETARI
Albert MËLYSHI

